



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
I SANKSIONEVE

Data: 11 Maj 2021

Nr: 60

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 36, PARAQITUR NË  
KQZ NË DATËN 09.05.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 11.05.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO - Relator  
Elvis ÇEFA - Anëtar  
Ilijan RUSMALI - Anëtar  
Koli BELE - Anëtar  
Ledio BRAHO - Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Partia Demokratike e Shqipërisë;

**OBJEKT:** Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 36, paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve datë 09.05.2021.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,



## VËREN:

Partia Demokratike e Shqipërisë, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 36 regj., datë 09.05.2021.

Në mbledhjen e datës 11.05.2021, ora 10:10, pas relatimit të z. Elvin Lako u konstatua se kërkesa ankimore nr. 36 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, të Komisionit Rregullator, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

## PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17, pika 3, shkronjat “a” e 18, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator,

## VENDOSI:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 36, datë 09.05.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 12 Maj 2021, në orën 11:30.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

**Elvin LAKO - Relator**

**Elvis ÇEFA - Anëtar**

**Ilirjan RUSMALI - Anëtar**

**Koli BELE - Anëtar**

**Ledio BRAHO - Anëtar**

